



Република Северна Македонија  
Republika e Maqedonisë së Veriut

## АПЕЛАЦИОНЕН СУД ГОСТИВАР ГЈУКАТА Е АПЕЛИТ ГОСТИВАР

Ул. Живко Брајковски бр.1, 1230 Гостивар / тел: 042-221-544 / info@asgostivar.mk  
Rr. Zhivko Brajkovski nr.1, 1230 Gostivar / tel: 042-221-544 / info@asgostivar.mk

**Rgj.nr.14/21**  
**08.01.2021**  
**GOSTIVAR**

Kryetari i Gjykatës së Apelit Gostivar, Bekim Mehmedi, në bazë të nenit 92 paragrafi 2 të Ligjit për Gjykatat ('Gazeta Zyrtare e RM', nr.58/2006, nr.62/2008, nr.35/2008 dhe nr.150/2010) dhe neni 7 paragrafi 1 pika 4 nga Rregullorja gjyqësore ('Gazeta Zyrtare e RM', nr.66/2013) sipas mendimit të marrë nga mbledhja e gjykatësve të Gjykatës së Apelit Gostivar, sot më datë 08.01.2021 vërtetoi të mëposhtmen:

### **PROGRAMI**

#### **për punë në Gjykatën e Apelit në Gostivar 2021**

Gjykatësi Bekim Mehmedi, me vendim të Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut nr.09-1893/1 nga data 09.12.2020 është zgjedhur kryetar i Gjykatës së Apelit në Gostivar.

Në pajtim me vendimin e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut, në këtë gjykatë është vërtetuar funksioni i 16 gjykatësve, duke përfshi edhe kryetarin e gjyqit.

Në vitin raportues 2019, funksionin e gjykatësit e kanë kryer 12 gjykatës, duke përfshi edhe Kryetarin e gjyqit.

1 (një) gjykatës nga këshilli i dytë civil ka shkuar në pension më datë 26.08.2020, ndërsa 3 (tre) gjykatës nga materia civile në periudhë prej tre muaj (tetor, nëntor, dhjetor) janë udhëzuar që përkohësisht funksionin e gjykatësit ta kryejnë në gjykatën e apelit në Shkup.

Nga këto arsye, sipas raportit të vitit 2020, gjykata ka pasur probleme me mungesën e gjykatësve gjegjësisht në sektorin penal ku funksionin e gjykatësit e kanë kryer 3 (tre) gjykatës përfshi edhe kryetarin e gjyqit, ku pritet që gjatë vitit 2021, problemet të thellohen edhe në materien civile nëse nuk merren masa për zgjedhje të gjykatësve të rinj, që të mundësohet funksionim më efikas i gjykatës.

Nga këto arsye, gjykatësit e sektorit civil do të marrin pjesë në këshillin penal me nga pesë gjykatës në punë me sektorin penal.

Në pajtim me orarin vjetor për punë në Gjykatën e Apelit Gostivar për vitin 2021, funksionin e gjykatësit do ta kryejnë 11 gjykatës përfshi edhe kryetarin e gjyqit.

Në pajtim me Rregulloren e organizimit të brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Gjykatën e Apelit në Gostivar, punët në shërbimet gjyqësore është paraparë t'i kryejë personeli administrativ teknik profesional, ndihmës profesional gjithsej 110 përmbarues, sipas Ligjit të Marrëdhënieve të Punës janë paraparë t'i kryejnë 10 përmbarues dhe në raport me punët e policisë gjyqësore është paraparë që punët t'i kryejnë 8 përmbarues, gjegjësisht gjithsej janë paraparë 128 përmbarues.

Mospërbushja e vendeve të punës në gjykatë, në pajtim me Aktin e sistematizimit, është 95 përmbarues.

Në pajtim me përbushjen e vendeve të punës sipas Aktit të sistematizimit të kësaj gjykate, në vitin raportues 2020, ka pasur gjithsej 32 nëpunës gjyqësor përfshi edhe administratorin e gjykatës, 1 pastrues dhe 1 vozitës.

Për shkak se një nëpunësi gjyqësor marrëdhënia e punës i është vënë në pushim për shkak të përsosjes profesionale deri më datë 11.02.2022, ndërsa më 2021 dy vende pune janë zbrazur si pasojë e shkuarjes së një bashkëpunëtori gjyqësor në Akademi për gjykatës dhe prokuror publik dhe vendi i administratorit të gjykatës është i zbrazur për shkak të shkuarjes së administratorit në pension më datë 07.08.2020.

Gjatë vitit 2020, në Gjykatën e Apelit në Gostivar ka pasur 2 (dy) punësime të reja me shpallje publike dhe atë: 1 (një) udhëheqës i administratës dhe 1 (një) bashkëpunëtor i ri gjyqësor dhe 12 (dymbëdhjetë) avansime të nëpunësve gjyqësor me konkurs të brendshëm dhe atë: 1 (një) udhëheqës i sektorit të informatikës, 7 (shtatë) këshilltarë gjyqësor, 2 (dy) bashkëpunëtor gjyqësor, 2 (dy) bashkëpunëtor përkthyes – interpretues.

Gjykata e Apelit në Gostivar, në vitin 2021 funksionimin dhe ta kryejë me **30 (tridhjetë)** nëpunës gjyqësor dhe **2 (dy)** personel teknik, dhe atë: **1 (një)** udhëheqës i administratës, **1 (një)** udhëheqës i sektorit të informatikës, **7 (shtatë)** këshilltarë gjyqësor, **1 (një)** këshilltarë informatike, **2 (dy)** bashkëpunëtor gjyqësor, **5 (pesë)** bashkëpunëtor të rinj gjyqësor, **2 (dy)** bashkëpunëtor përkthyes – interpretues, **1 (një)** bashkëpunëtor i ri – ekonomist, **1 (një)** referent i pavarur kontabilist, **1 (një)** referent i pavarur gjyqësor, **1 (një)** referent i pavarur gjyqësor në sektorin e informatikës, **1 (një)** referent i lartë në sekretarinë e sektorit penal, **1 (një)** referent i ri gjyqësor në sekretarinë e sektorit civil, **1 (një)** referent i lartë në arhivën e gjyqit, **5 (pesë)** referent gjyqësor – daktilograf, **1 (një)** vozitës dhe **1 (një)** pastrues.

Gjykata ka në shërbim një sallë për gjykime me sistem të regjistrimit të zërit.

Në lidhje me aplikimin e dispozitave të Ligjit për procedurë kontestimore dhe Ligji për Procedurë Penale për mbajtje të seancave publike sipas lëndëve, përveç regjistrimit të zërit për sektorin civil, planifikohet që në tërësi të përgaditet salla e gjykimeve edhe

për lëndët për të cilat mbahet seancë publike nga sektori penal, si dhe të pajiset me aparaturë audio-vizuale.

Pritet që gjatë vitit 2021 të zgjidhjen gjykatës të rinj një Gjykatën e Apelit në Gostivar.

Në vitin raportues 2020, gjithsej në punë ka pasur 3261 lëndë, nga të cilat 338 janë transferuar si të pambaruara nga viti raportues 2019 dhe 2923 të regjistruara si lëndë të reja.

Fluksi i lëndëve të reja në krahasim me vitin e kaluar 2019, ku numri ishte 3521 është zvogluar për 598 lëndë dhe numri tani është 2923.

Në fund të vitit raportues 2020 janë zgjedhur 2790 lëndë, dhe kanë ngelur të pambaruara 471 lëndë.

Gjatë vitit 2020 janë regjistruar 1135 lëndë nga udhëheqësia gjyqësore.

Duke pasur parasysh që sektori penal është me 3 gjykatës që punojnë me lëndët penale dhe ato për kundërvajtje, pritet që gjatë vitit 2021 sektori penal të përmbushet edhe me dy gjykatës të sferës penale.

Me qëllim që gjyqi të jetë më efikas dhe me kualitativ në punën e tij në vitin 2021, është e duhur që numri i lëndëve të pazgjedhura nga të gjitha llojet të jetë dukshëm i zvogluar, kualiteti i punës dhe zgjedhja e lëndëve të jetë më i lartë, zgjedhja e lëndëve të kryhet në kohë, në pajtim me ligjet procesuese, rregulloren gjyqësore dhe Programin për punë të Gjykatës së Apelit në Gostivar.

Në vitin 2020 përmes prokurimeve publike në pajtim me planin për prokurime publike të viti 2020, në gjyq nga mjetet e planifikuara të Këshillit gjyqësor buxhetor të ndara për 2020, për shfytëzuesit e buxhetit, janë realizuar prokurimet e mëposhtme të mjeteve, shërbimeve dhe punëve, dhe atë:

- prokurim për inventar të vogël dhe mjete për mirëmbajtje të higjienës;
- prokurim i lëndës djegëse për veturën e gjyqit;
- prokurim i materialeve për AOP toner dhe printer;
- prokurim i materialeve për zyrë;
- prokurim publik në grup për shërbime të internetit;
- prokurim në grup të shërbimeve të postës së Maqedonisë;
- prokurim në grup i letrës për printim dhe kopjim të formatit A4 (210x297) 80 gram, ngjyrë e bardhë;
- prokurim i shërbimeve për përdorim të linjës fikse;
- prokurim në grup i shërbimeve për shfrytëzimin e linjës telefonike celulare;
- prokurim për përgaditje të Gjykatës së Apelit me çertifikatën e sistemit për udhëheqje të kualitetit ISO 9001:2015.

Gjithashtu në vitin 2020, është lidhur marrëveshje për kryerje të pranimit dhe dërgesës së letrave gjyqësore dhe shërbimeve të tjera postare dhe marrëveshje për shfrytëzim të shërbimeve të internetit dhe telefonit.

Në pajtim me nenin 92 paragrafi 1 të Ligjit mbi Gjykatat, mbledhje e gjykatësve e përbëjnë të gjithë gjykatësit dhe për këtë shkak pjesëmarrja në mbledhje është e domosdoshme, ndërsa mungesa në mbledhje duhet të paralajmërohet dhe të arsyetohet.

Në bazë të nenit 92 paragrafi 2 nga Ligji për gjykatat dhe neni 7 nga Rregullorja gjyqësore, me programin për punë të gjykatës konkretizohen punët dhe detyrat nga rrethi i gjyqit, veçanërisht lloji dhe numri i lëndëve, punët dhe detyrat për ndjekje të studimit të problemeve që dalin nga praktika e gjykatës që janë në interes të zbatimit të vetëm dhe të drejtë të Ligjit, dhënia e ndihmës të gjykatat themelore të rajonit të këtij gjyqi, nëpërmjet vizitave të punës të gjykatësve të caktuar për bashkëpunim me gjykata themelore konkrete, marrja e qëndrimeve sipas pyetjeve të dejtësisë dhe të tjera.

Me konkretizimin e punëve dhe detyrave nga ky gjyq në kryerjen e funksionit të gjykatës të miratuar me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë, ligjet dhe marrëveshjet ndërkombëtare në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë, sigurohet zbatim dhe mbrojtje e të drejtës dhe lirive të njeriut.

Sipas kësaj, qëllime dhe funksione, në pajtim me Programin për punë të Gjykatës së Apelit në Gostivar, janë:

- zgjedhja në kohë dhe kualitative e lëndëve të evidentuara në sistemin AKMIS;
- mbrojtja dhe respektimi i të drejtave dhe lirive të njeriut;
- zbatim i paanshëm i të drejtës pa marrë parasysh pozitën dhe funksionin e palëve;
- sigurim i të drejtës dhe vendosja e kushteve që secili njeri të jetojë sigurtë në korniza të zbatimit të të drejtës;
- dhënia e ndihmës të gjykatat themelore në rajonin e këtij gjyqi;
- përgaditja e analizave, informacioneve etj të cilat dë të ndihmojnë në zbatimin e drejtë të drejtësisë;
- harmonizimi i punës së kësaj gjykate me gjykatat themelore të rajonit nëpërmjet raporteve për punë të gjykatave, veçanërisht për arsyet e lëndëve të vjetra, me vizitat e gjykatave themelore me zgjedhje të lëndëve konkrete në procedurë ankimese;
- ndjekja e planit për ulje të mbetjes së lëndëve të pazgjedhura në Gjykatën e Apelit në Gostivar dhe Gjykatave Themelore nga rajoni i kësaj gjykate;
- takime dhe këshillime të organizuara me gjykatat themelore në lidhje me punën e gjykatësve;
- takime në nivel të Gjykatave të Apelit për barazim të praktikës gjyqësore, me Gjykatën e Lartë të Republikës së Maqedonisë, avokaturave, organeve shtetërore, posaçërisht me Shoqatën e gjykatësve në lidhje me edukimin e gjykatësve dhe Këshillin për administratë gjyqësore dhe organeve të tjera shtetërore, për shkak të edukimit edhe të nëpunësve gjyqësor;
- realizimi i Programës së Akademisë për gjykatës dhe prokurorët publik dhe personelin administrativo – teknik të Gjykatës së Apelit në Gostivar, do të kryhet ashtu si është paraparë në kalendarin e Akademisë.
- përmirësim i vazhdueshëm dhe mirëmbajtje e sistemit për menaxhim të kualitetit ISO9001:2015 me kontrole të rregullta të brendshme nga kontrollues të brendshëm të çertifikuar në Gjykatën e Apelit në Gostivar, ndjekja e rregullt dhe përmirësim i dokumentacionit të plotë të sistemit me qëllim të raportit pozitiv për kontroll të jashtëm nga trupi çertifikues INTERCEPT.

Për realizimin e programit kujdeset Kryetari i gjykatës, gjykatësit dhe të punësuarit në gjykatë.

Në vitin 2020 puna në Gjykatën e Apelit në Gostivar do të kryhet nëpërmes:

- Sektorit Penal me këshillat e specializuar;
- Sektorit Civil me këshillat e specializuar;
- Departamenti i praktikës gjyqësore dhe evidencës;
- Departamenti për shërbime profesionale;
- Departamenti i informatikës;
- Departamenti për marrëdhënie me publikun;
- Departamenti për punë finansiare-materiale; dhe
- Departamenti për burime njerzore;

## **PUNA SIPAS LËNDËVE**

### **I. SEKTORI PENAL.**

Në Sektorin Penal me orarin për punë të vitit 2021, janë përcaktuar të punojnë 4 gjykatës, përfshi edhe Kryetarin e gjykatës, 1 udhëheqës i administratës, 3 këshilltarë gjyqësor, 1 bashkëpunëtor profesional dhe 1 bashkëpunëtor i ri gjyqësor.

Në vitin 2021 sektori penal do të punojë me:

- një Këshill penal me tre gjykatës, që do të punojnë me KSZH dhe KR lëndë;
- një Këshill penal me pesë gjykatës, që do të veprojnë me lëndët KZH;
- dy Këshilla penal që do të veprojnë sipas KZH lëndëve;
- një Këshill penal për delikuencë minore, që do të veprojnë me KZHM lëndët;

Në vitin 2020 në sektorin penal janë transferuar si të pazgjedhura nga viti 2019, 56 KZH lëndë dhe janë pranuar 446 KZH lëndë të regjistruara, gjegjësisht gjithsej sipas sistemit AKMIS në punë ka pasur 502 KZH lëndë, në fund të vitit raportues 2020 janë zgjedhur 349 lëndë KZH, ndërsa të pambaruara kanë ngelur edhe 153 lëndë KZH.

Në vitin 2021, pritet që në punë të ketë rreth 500 KZH lëndë.

Në vitin 2020 në Sektorin Penal sipas sistemit AKMIS janë regjistruar 14 KZHM lëndë të reja të pranuar dhe janë zgjedhur 12 KZHM lëndë, ndërsa si të pambaruara kanë ngelur 2 KZHM lëndë.

Në vitin 2021 pritet që në punë të ketë rreth 40 lëndë KZHM.

Në vitin 2020 në sektorin penal të transferuara si të pazgjedhura nga viti 2019 janë 5 lëndë KSZH, të reja të pranuar 144 lëndë KSZH, gjegjësisht gjithsej në punë në vitin 2020 ka pasur 149 KSZH lëndë, në vitin raportues 2020 janë zgjedhur 138 lëndë KSZH, dhe si të pazgjedhura kanë ngelur 11 lëndë KSZH.

Në vitin 2021 gjithsej me mbetjen, pritet që në punë të ketë rreth 200 lëndë KSZH.

Në vitin 2020 në sektorin penal të transferuara si të pazgjedhura nga viti 2019 janë 7 lëndë PRKZH, të pranuar të reja janë regjistruar 569 PRKZH lëndë, gjegjësisht

gjithsej në vitin 2020 ka pasur 576 lëndë, në vitin raportues 2020 janë zgjedhur 556 lëndë PRKZH, ndërsa si të pazgjedhura kanë ngelur 20 lëndë PRKZH.

Në vitin 2021, pritet që në punë të ketë rreth 800 lëndë PRKZH.

Në vitin 2020 në sektorin penal sipas sistemit AKMIS janë regjistruar 40 lëndë të reja KR, gjejjësisht janë zgjedhur 39 lëndë KR, ndërsa si të pazgjedhura kanë ngelur 1 lëndë KR.

Në vitin 2021 pritet që në punë të ketë rreth 60 lëndë KR.

Në vitin 2021 në sektorin penal pritet që të ketë në punë nga të gjitha llojet e lëndëve rreth 1600 lëndë.

Lëndët penale në vitin 2021 do të zgjidhjen, më pak të komplikuar në afat prej 3 muaj, më të komplikuar më së voni deri në 6 muaj nga pranimiti i lëndës në gjyq, përfshi edhe lëndët në të cilat deklarohet prokurori publik i lartë dhe lëndët për të cilat mbahen seanca publike, në kushte të numrit të duhur të gjykatësve të sektorit penal, gjejjësisht nëse zgjedhjen edhe dy gjykatës, të cilët do të punojnë në këtë sektor.

Në pajtim me nenin 182 të rregullores gjyqësore, lëndët e sektorit Penal do të zgjidhen sipas rradhës së pranimit, përveç në raste urgjente ose në rastet e tjera të arsyetuara, në pajtim me paragrafin 3 të këtij ligji.

Për zgjedhjen e lëndëve sipas rradhës së pranimit ose marrja në punë e rasteve urgjente ose lëndëve të tjera me prioritet, kujdeset gjykatësi që punon me lëndën dhe kryetari i gjyqit.

Secili gjykatës nga sektori penal është i detyruar që në çdo 3 muaj të raportojë te kryetari i gjyqit për lëndët e pazgjedhura në afatin e përcaktuar me raport të shkruar duke theksuar arsyet e vonesës.

Gjatë zgjedhjes së lëndëve penale dhe ato për kundërvajtje, ku ka ardhur deri te vjetërsimi i ndjekjes penale dhe për kundërvajtje, duhet të vërehen arsyet, dhe atë:

- nëse lëndët e paraburgimit dërgohen me ankesë në kohë ose jo, dhe arsyet për këtë;

- në të gjitha llojet e lëndëve gjatë zgjedhjes të vërehen të gjitha rastet kur gjykatat e shkallës së parë nuk veprojnë sipas udhëzimeve të Gjykatës së Apelit Gostivar dhe Gjykatës së Lartë të Republikës së Maqedonisë së Veriut;

- të vërehen edhe këta punë në lidhje me pyetjet e drejtësisë, përgaditja e analizave, informacioneve dhe indikacioneve me qëllim që të shihet cilat gjyqe nuk zbatojnë dhe respektojnë Ligjin për administrim të lëvizjes së lëndëve nëpër gjykata.

## **II. SEKTORI CIVIL.**

Në sektorin civil me orarin për punë për vitin 2021, janë përcaktuar që të veprojnë 7 gjykatës, 4 këshilltarë gjyqësor dhe 3 bashkëpunëtorë të rinj.

Në vitin 2021 sektori civil do të punojë me:

- **dy** këshilla civil që do të veprojnë me lëndët e regjistrit GZH;
- **një** këshill për punë tregëtare dhe kontesteve të punës, që do të veprojë me regjistrat TSZH dhe ROZH;
- **një** këshill për punët e dëmshpërblimit të dëmeve i cili do të veprojë në pajtim me Ligjin për përgjegjësi civile për shpifje dhe ofendim, lëndë me shenjë P5 – vërtetim të përgjegjësisë civile për shpifje dhe ofendim;
- **një** këshill të posaçëm i cili do të veprojë me lëndët civile të lidhura me falimentim.

Në vitin 2020 janë transferuar si lëndë të pambaruara nga viti 2019, 160 lëndë të regjistrit GZH, janë pranuar të reja 995 në regjistrin GZH, gjegjësisht gjithsej në punë ka pasur 1155 lëndë të regjistrit GZH, dhe si të pazgjedhura kanë ngelur 191 lëndë në regjistrin GZH.

Në vitin 2021, pritet që në punë të ketë rreth 1800 lëndë GZH.

Në vitin 2020 në sektorin civil janë transferuar si të pazgjedhura nga viti 2019, 80 lëndë të regjistrit ROZH, të reja janë regjistruar 522 lëndë ROZH, gjegjësisht gjithsej në punë për vitin 2020 ka pasur 602 ROZH lëndë, në vitin raportues 2020 janë zgjedhur 548 lëndë ROZH, ndërsa si të pazgjedhura kanë ngelur 54 lëndë ROZH.

Në vitin 2021, pritet që në punë të arrijnë rreth 860 lëndë ROZH.

Në vitin 2020 në sektorin civil janë transferuar si të pazgjedhura nga viti 2019, 30 lëndë nga regjistri TSZH, të reja të regjistruara 172 lëndë TSZH, gjegjësisht gjithsej në punë ka pasur 202 lëndë TSZH, në vitin raportues 2020 janë zgjedhur 163 lëndë TSZH, ndërsa si të pazgjedhura kanë ngelur 39 lëndë TSZH.

Në vitin 2021 pritet që në punë të ketë afërsisht 300 TSZH lëndë.

Në vitin 2020 gjithsej në punë ka pasur 21 lëndë R dhe të gjitha janë zgjedhur.

Në vitin 2021 pritet që në punë të ketë rreth 40 lëndë.

Në vitin 2021 në sektorin civil nga të gjitha llojet e lëndëve pritet të ketë gjithsej 3000 lëndë.

Lëndët civile në vitin 2021, do të zgjidhen më pak të komplikuar në afat prej 3 muaj, më të komplikuarat në afat prej 6 muaj nga pranimi në gjykatë.

Në përputhje me nenin 182 të Rregullores Gjyqësore, lëndët e Sektorit Civil do të zgjidhen sipas rradhës së pranimit, përveç në rastet urgjente dhe rastet tjera të arsyetueshme, në pajtim me paragrafin 5 të këtij neni.

Për zgjedhjen e lëndëve sipas rradhës së pranimit ose marrjes në punë fillimisht të lëndëve urgjente dhe lëndëve me prioritet, këtë përgjegjësi e ka gjykatësi i caktuar në lëndë dhe Kryetari i gjykatës.

Çdo gjykatës i Sektorit Civil është i obliguar që në çdo 3 muaj të raportojë Kryetarin e gjyqit për lëndët e pazgjedhura në afatet e caktuara me raport me shkrim duke i përmendur arsyet e vonesës.

Gjatë zgjedhjes së të gjitha llojeve të lëndëve, do të ju kushtohet rëndësi e veçantë:

- lëshimeve në gjykatat themelore në lidhje me kohëzgjatjen e procedurës;
- dërgesa e lëndëve me ankesë më lëshimet dhe të papërgaditura;
- vonesa gjatë dërgesës së ankesës së lëndëve;
- lëshimeve të tjera.

Me qëllim që të zmadhohet azhurimi i gjykatave të rajonit të Gjykatës së Apelit, është me rëndësi të shikohen lëshimet gjatë vizitave të punës nëpër gjykata ose me vëretje të posaçme, pavarësisht nga vizita e Gjyqit.

### **III. SEKTORI PËR PRAKTIKE GJYQËSORE DHE EVIDENCË.**

Gjatë vitit 2021 në këtë sektor do të punojnë: Kryetari i Gjyqit, gjykatësit dhe bashkëpunëtorët profesional, ashtu si është caktuar me Orarin Vjetor të Gjykatës së Apelit në Gostivar në vitin 2021.

Në faqen e internetit të gjykatës, është publikuar formular për praktikë gjyqësore që kryetarët e këshillave duhet ta mbushin me të dhëna pasi që këshilli të ketë vlerësuar se vendimi duhet të shenjëzohet si shembull në praktikën gjyqësore.

Kryetarët e sektorëve e përcaktojnë mënyrën në të cilën sektori për praktikë gjyqësore i evidenton mendimet juridike të pranuar në seancat e sektorëve dhe mënyrën e evidentimit të praktikës gjyqësore me aplikacionin e ri të teknologjisë bashkëkohore, instalimin qendror dhe mirëmbajtje dhe qasje të lehtë.

Në seancën e Sektorit do të silllet Plan për ndjekjen e praktikës gjyqësore dhe paraqitjen e dukurive shoqërore dhe raportet për studim të tyre dhe punë të mëtutjeshme dhe do të formulohen propozime dhe pyetje që fliten në seancat e sektorëve për shkak të marrjes së qëndrimit për barazim të praktikës gjyqësore.

#### **Qëllimet e planit.**

Me planin vjetor përcaktohen qëllimet në lidhje me punën e rregullt dhe efikase të sektorit, me qëllim të promovimit dhe barazimit të praktikës gjyqësore në raport me aplikimin e Ligjit për veprim të rregullt nëpër Republikën e Maqedonisë së Veriut me theks të veçantë të këtij gjyqi dhe gjykatave të këtij rajoni.

Në Sektor të evidentohen:

- vendimet e Gjyqit Evropian për të drejtat e njeriut në Strazburg;
- vendimet e Gjyqit Suprem të Republikës së Maqedonisë së Veriut ku ka pikëpamje ligjore, punime të ekspertëve dhe rishikimet e botuara në Buletinin e Praktikës Gjyqësore të Gjykatës Supreme të RMV dhe Mbledhjen e Vendimeve Gjyqësore, si dhe Parimet e Gjykatës Supreme;



- qëndrimet e marra të sektorëve të Gjykatës së Apelit për çështjet e veçanta juridike të inicuar nga Gjykata e Apelit në Gostivar dhe Gjykatave Themelore të rajonit të kësaj gjykate.
- pikëpamjet e përbashkëta juridike në nivelin e Gjykatave të Apelit të RMV;
- analiza, informacione dhe indikacione të Gjykatës së Apelit Gostivar dhe gjykatave themelore të rajonit të kësaj gjykate;
- ndjeshmëri, rishikime dhe materiale të tjera për Buletinin e Praktikës së Gjykatës së Apelit Gostivar ,
- materiale për edukimin e gjykatësve dhe kuadrit profesional në nivel të Gjykatës së Apelit në Gostivar;
- materiale të tjera të rëndësishme për evidentimin dhe praktikën gjyqësore;
- axhurim i rregullt dhe mirëmbajtje e të dhënave për Programën e re të praktikës gjyqësore e cila është plotësisht e ripërpiluar gjatë vitit 2020.

### **Resurse për zbatimin e Planit.**

Personat përgjegjës në zbatimin e planit janë Kryetari i Gjyqit, Kryetari i sektorit për praktikë gjyqësore, kryetarët e sektorit civil dhe penal dhe administratori i gjykatës si dhe bashkëpunëtorët profesional të cilët emërohen në mënyrë alternative sipas planit vjetor për punën e gjykatës si dhe tekniku i teknologjisë informative.

### **Aktivitete për zbatimin e Planit.**

Plani vjetor i vitit 2020 do të zbatohet nëpërmjet aktiviteteve të mëposhme:

- Analiza e lëndëve përmes bashkëpunimit me mbledhje aktive në nivel të sektorit me gjykatësit e Gjykatës së Apelit Gostivar veçmas në sektorin Civil dhe sektorin Penal.
- Propozime për të cilat vendimet do të referohen si praktikë gjyqësore;
- Ndjekja e praktikës gjyqësore në Gjykatat tjera të Apelit në Republikën e Maqedonisë së Veriut,
- Ndjekja e vendimeve të Gjykatës Supreme të RMV;
- Ndjekja e vendimeve të sjella nga gjykata për të drejtat e njeriut në Strazburg;
- Ndjekja e literaturës profesionale ku publikohen vendimet gjyqësore (publikime nga sfera e drejtësisë dhe bulentineve të ndryshme);
- Ndjekja e trajnimeve që organizohen me qëllim të harmonizimit të praktikës gjyqësore dhe atë nga Akademia e gjykatësve dhe prokurorëve publik të RMV dhe organizatave ndërkombëtare.
- Pjesëmarrje aktive për përgaditjen e temave për trajnime me propozime konkrete për tema me qëllim të barazimit të praktikës gjyqësore.
- Përgaditje dhe publikim i Buletineve.
- Rraportet mujore – regjistra për mbajtje të mbledhjeve në nivel të Gjykatës së Apelit,

### **KRYETARI I GJYQIT.**

Nga lëndët të cilat janë në rrethin dhe përgjegjësinë funksionale të Kryetarit të Gjyqit në regjistrat ‘SU’ dhe ‘SU1’ deri në ‘SU7’, ‘SU.DOV’, ‘SU.STR.DOV’ dhe ‘UPP’, ‘SU-IZZ’, në fund të vitit 2020 u zgjodhën gjithsej sipas të gjitha regjistrave 1135 lëndë, lëndë të pazgjedhura nuk janë të evidentuara në regjistrat e këtij gjyqi, ndërsa në vitin 2021 pritet të ketë po aq lëndë.

Në vitin 2021 Kryetari i Gjyqit do të kujdeset për punë të plotë të Gjykatës në të gjitha pjesët e punës dhe do të marrë masa në atë drejtim në pajtim me ligjin.

Në pajtim me nenin 23 të rregullores gjyqësore, kryetari i Gjykatës së Apelit në Gostivar, me kryetarët e gjykatave themelore të këtij rajoni nën kompetenca të Gjykatës së Apelit në takime të përbashkëta së paku 2 herë në vit do të analizojnë të dhënat nga statistikat gjyqësore dhe raportet e punës së gjykatave themelore që do të marrin masa për barazim të praktikës gjyqësore, Gjykata e Apelit do të nxjerr dobësitë e punës së gjykatave themelore me propozim për mënjanimin e tyre me çka do të njoftohen ene institucionet përkatëse të RMV.

### **LËNDË TË VJETRA DHE ME PRIORITET**

Kryetarët e gjykatave themelore në rajonin e Gjykatës së Apelit në Gostivar, do të monitorojnë punën e gjyqtarëve përmes programit AKMIS, që është detyrimi i tyre ligjor, do të monitorojnë gjendjen e lëndëve të vjetra të pazgjidhura përmes organeve punuese, dhe për Kryetarin e gjykatës do t'i propozojnë masa për përpilimin e planeve për zgjidhjen e lëndëve të vjetra. Kryetarët do të takohen më shpesh për të monitoruar përmbushjen e planit dhe nëse është e nevojshme, ta ndryshojnë dhe plotësojnë atë.

Gjykatësit do të paraqesin raport me shkrim për lëndët e vjetra të pa zgjidhura në raportet mujore me arsyet e mos zgjidhjes dhe një plan kur lënda do të zgjidhet.

Në vitin 2021 është përgjegjësi e të gjithëve, përfshirë edhe Gjykatën e Apelit në Gostivar, që lëndët e vjetra të zgjidhen në gjykatat themelore deri në gjysmën e parë të vitit, dhe lëndët nga 2018, 2019 dhe 2020 të zgjidhen deri në fund të vitit 2021.

Këto situata do të shqyrtohen në takimet e përbashkëta ndërmjet Kryetarit të Gjykatës së Apelit në Gostivar dhe Kryetarëve të gjykatave kryesore në rajonin e kësaj Gjykate.

Zgjidhja në kohë e lëndëve të vjetra do të kontribuojë në zvogëlimin e ankesave të qytetarëve për punën e gjykatave, si dhe në uljen e shpenzimeve në Këshillin Buxhetor Gjyqësor për pagesën e tarifave gjyqësore në një kohë të paarsyeshme.

Në Gjykatën e Apelit në Gostivar është planifikuar që në vitin 2021 të mos ketë lëndë më të vjetra se 6 muaj nga data e pranimit të kësaj gjykate, me përjashtim të atyre lëndëve që për arsye objektive nuk mund të zgjidheshin brenda asaj periudhe.

### **Shqyrtime dhe informacione përmbledhëse**

Për vitin 2021 do të përgatiten shqyrtime dhe informacione përmbledhëse.

- përmbledhjen në gjykatë për vendimet e shfuqizuara dhe të ndryshuara nga regjistrat KZH, KZHM, KSZH, PRKZH dhe KR, të cilat do t'i përgadisë gjykatësi Abdulbari Ramadani me bashkëpunëtorin gjyqësor Vesna Iliq.

- përmbledhjen në gjykatë për vendimet e shfuqizuara dhe të ndryshuara nga regjistri GZH, do t'i përgadisë gjykatësi Velko Strashevski me bashkëpunëtorin gjyqësor Leonora Jakupi.

- përmbledhjen në gjykatë për vendimet e shfuqizuara dhe të ndryshuara nga regjistri ROZH, do t'i përgadisë gjykatësi Izet Ismaili me bashkëpunëtorin gjyqësor Arjeta Iljazi.

- përmbledhjen në gjykatë për vendimet e shfuqizuara dhe të ndryshuara nga regjistri GZH, do t'i përgadisë gjykatësi Rafis Idrizi me bashkëpunëtorin gjyqësor Aleksandar Duroski.

- informacioni për veprim me lëndët UPP të Gjykatës Apelit Gostivar për vitin 2021 dhe

- informacioni për gjendjen e për zgjidhjen e lëndëve të vjetra në gjykata themelore për vitin 2021 do t'i përgadisnin Kryetari i gjykatës dhe Administratori gjyqësor.

### **TAKIMET DHE KËSHILLAT**

Gjatë vitit 2021 janë paraparë takime dhe këshilla:

- takimet e Kryetarit të GJA Gostivar me Kryetarët e Gjykatave themelore në këtë rajon të apelit, për çështje të administratës gjyqësore dhe çështje të tjera aktuale.

- Takimet e Kryetarit të GJA Gostivar me Kryetarët e Gjykatave të Apelit në Shkup, Shtip dhe Manastir, për çështje aktuale dhe çështje ligjore që lidhen me zgjidhjen e lëndëve.

- takimi i Kryetarëve të Gjykatave të Apelit dhe Gjykatës Supreme sipas sektorëve,  
- takimi i Kryetarit të GJA Gostivar dhe Kryetarëve të Sektorëve me organe dhe institucione të tjera shtetërore për të zgjidhur problemet që do të paraqiten gjatë punës së Gjykatës dhe Gjykatave Themelore të regjionit të GJA Gostivar.

Në vitin 2020 gjykatësit do të marrin pjesë në punën e Akademisë për Gjykatës dhe Prokurorë Publikë, si:

- edukatorë dhe mentorë të materialit për të cilin ata aftësohen për të përçuar njohuritë dhe përvojën kolegëve të rinj;

- pjesëmarrës me qëllim të përsosjes profesionale të gjyqtarëve, në përputhje me Programin e Akademisë për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publik;

Stafi profesional dhe stafi administrativ dhe teknik në Gjykatën e Apelit Gostivar do të marrin pjesë në konsultimet e organizuara nga Akademia për Gjykatësit dhe Prokurorët Publik.

Vendim për pjesëmarrjen në këshillime, tryeza të rrumbullakëta dhe tjera, në mënyrë të pavarur nga Programi i Akademisë, do të sjellë Kryetari i Gjykatës dhe Kryetarët e Sektorëve në varësi të rëndësisë të çështjeve që do të jenë temë e këshillimit, me qëllim të zhvillimit të përsosjes profesionale.

Kryetarët e Sektorëve në Gjykatën e Apelit Gostivar, deri në fund të shkurtit të vitit 2021, do të përgatisin programet e punës së sektorëve.

Programi i Punës i sektorëve të Gjykatës Apelit Gostivar do të përcaktojë kalendarin për vizitat e punës dhe mbledhjet e Gjykatave të Shkallës së Parë në rajonin e GJA Gostivar për vitin 2020.

### **VIZITA DHE KONTROLLI I GJYKATAVE THEMELORE LOKALE**

Vizitat dhe kontrollet do të bëhen për të monitoruar punën e Gjykatave Themelore në regjionin e GJA Gostivar, për të ofruar ndihmë profesionale dhe për të vlerësuar situatën me lëndët e vjetra të pa zgjidhura.

Kryetarët e Gjykatave të Shkallës së parë Tetovë, Gostivar, Kërçovë dhe Dibër marrin përsipër të paraqesin në raportet e hollësishme të dhënat e mëposhtme:

- lëndët e zgjedhura të Këshillit Penal në të cilën nuk ka ankesë nga Prokuroria Themelore Publike;
- të gjitha lëndët për zbatimin e sanksioneve për vitin 2020 - 2021;
- programin për stafin e administratës gjyqësore të Gjykatave Themelore të rajonit të Gjykatës së Apelit;
- orarin për gjyqtarët e Gjykatave të Shkallës së Parë të rajonit të Gjykatës së Apelit;
- raportin për numrin e lëndëve në të gjitha fushat për vitin 2021;

Gjatë vitit 2021, gjatë vizitave të punës të Gjykatave Themelore, situata duhet të vëzhgohet gjatë pranimit të lëndëve të reja nga gjyqtarët të cilët janë caktuar sipas programit AKMIS, d.m.th. nëse pranimi i lëndës regjistrohet të njëjtën ditë ose më së voni deri në ditën tjetër të punës, sipas Ligjit dhe Rregullores të Gjykatës.

Gjatë vizitave të punës, Gjykatave Themelore do t'u kërkohej të respektojnë dispozitat e Ligjit për administrimin e lëvizjes të lëndëve në Gjykata dhe çdo vendim i marrë të publikohet në faqen e internetit të Gjykatës. Më pas, gjatë vizitave në Gjykatat Themelore do të udhëzohen t'i kushtojnë vëmendje shpërndarjes së lëndëve te gjyqtarët me sistemin AKMIS, veçanërisht të ketë kujdes të mos shfaqet fenomeni që lënda e njëjtë në ditën e njëjtë të shpërndahet disa herë gjyqtarëve të ndryshëm, sepse shpërndarja e tillë është në kundërshtim me ligjin dhe dispozitat e Rregullores së Gjykatës dhe Ligjit për Menaxhimin e Lëvizjes së Lëndëve.

Gjatë vitit 2021, gjyqtarët e Gjykatave Themelore do të urdhërohen pas revokimit të vendimeve të shkallës së parë në rigjykim, të veprohet në përputhje me udhëzimet e dhëna në vendimet e marra nga gjyqtarët e GJA Gostivar dhe sa më shpejt, pasi ky detyrim mbështetet nga dispozitat e LPK-së dhe Rregullorja e Gjykatës. Gjithashtu, gjatë kryerjes së vizitave të punës në vitin 2021, përveç vërejtjeve të mësipërme, theksohet nevoja për të rregulluar në mënyrë kronologjike shkresat e lëndës të paraqitur në shkallë të dytë, si dhe për t'i ofruar gjykatës një numër të mjaftueshëm të kopjeve të vendimeve të gjykatës dhe ankesave të palëve.

Gjyqtarët gjatë vizitave të punës gjithashtu duhet të marrin parasysh edhe gjendjen e lëndëve të vjetra të pazgjidhura dhe arsyet për ta, dhe në raport me qëllim të harmonizimit të raporteve është e nevojshme të tregojë të gjitha momentet e rëndësishme nga pranimi i lëndës deri te kontrolli, dhe veçanërisht:

- numrin e lëndës;
- bazën;
- palët;

- te cili gjyqtar është / nëse ndryshohen, më shumë gjyqtarë edhe ajo të regjistrohet, kur është pranuar lënda, kur është është caktuar për herë të parë lënda, sa seanca janë mbajtur para dënimit të parë, me datë, dënimin e parë / konfirmuar, refuzuar /;
- me datën e sjelljes dhe ekspeditës;
- ankesa prej kujt dhe kur është sjellë;
- kur ankesa është sjellë nga gjykata e shkallës së dytë;
- vendimi i gjykatës të shkallës së dytë me numër dhe datë;
- kur është kthyer lënda në gjykatën e shkallës së parë;
- kur është caktuar pas kthimit;
- sa seanca janë mbajtur pas kthimit /me datë/, aktgjykimi i dytë;
- a është vepruar sipas udhëzimeve të gjykatës së shkallës së dytë;
- nëse anulohet për së dyti apo më shumë, të vazhdohet me orarin e njëjtë nga dita e kontrollit.

Gjatë vizitës, përveç kontrollit të lëndëve të vjetra të pazgjidhura, gjyqtarët do të japin ndihmë juridike për çështje të caktuara juridike që lidhen me zgjidhjen e lëndëve për të cilat më parë kanë kërkuar ndihmë seksionet civile të gjykatave, dhe do të paraqesin vëzhgimet dhe vërejtjet e konstatuara gjatë zgjidhjes të lëndëve të shkallës së dytë, në mënyrë që të kapërcehen pikat e dobëta në zgjidhjen e lëndëve të shkallës së parë dhe tregon për çështje të tjera me rëndësi për punën e Gjykatës.

Për veprimet e ndërmarra gjatë vizitave të bëra nga gjyqtarët për të përgatiten raporte të vizitës që janë dorëzuar në Gjykatat Themelore në rajonin e kësaj Gjykate, Këshilli Gjyqësor i R. Maqedonisë Veriut, Gjykata Supreme e Republikës Maqedonisë Veriut dhe Ministria e Drejtësisë të RMV-së në pajtim me nenin 23 të Rregullores së Gjykatës.

Kryetari i Gjykatës, së bashku me Kryetarët e seksioneve dhe Kryetarët e Gjykatave Themelore, të analizojnë të dhënat nga statistikat e Gjykatës dhe raportet e punës së Gjykatave Themelore, dhe të marrin masa për harmonizimin e praktikës gjyqësore, dhe të nxjerrin në pah pikat e dobëta në punën e Gjykatave Themelore, me propozim për heqjen e tyre, për të cilat do të njoftohen institucionet shtetërore kompetente në Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Kryetarët e gjykatave të shkallës së parë në rajonin e apelit dhe Gjykata e Apelit në Gostivar duhet të miratojnë një Plan për zgjidhjen e lëndëve të vjetra dhe Trupi i Punës për Menaxhimin e Lëvizjes të Lëndëve duhet të monitorojë zgjidhjen e lëndëve të vjetra të pazgjidhura dhe të raportojë një herë në muaj në Këshillin Gjyqësor të RMV-së dhe të marrë masa për tejkalimin e situatës me lëndët e vjetra, vonesën në zgjidhjen e lëndëve të vjetra dhe mbetjen e lëndëve të vjetra, duke urdhëruar gjyqtarët të paraqesin për këtë qëllim raport me shkrim për lëndët e vjetra në raportet mujore, gjithashtu të japin arsye për mos zgjidhjen dhe të përgatisin plan të tyre kur lëndët do të zgjidhen në vitin 2021, të cilat shqyrtohen nga Kryetari i Gjykatës dhe Kryetarët e sektorëve individualisht dhe në mbledhjet e seksioneve.

Kryetari i GJA Gostivar, së bashku me Kryetarët e Gjykatave Themelore, do të shqyrtojnë situatën me administratën gjyqësore, në përputhje me nenin 7 të Rregullores së Gjykatës.

Gjykatësit gjatë kontrollit do të shikojnë statusin e lëndëve të vjetra të pa zgjidhura dhe arsyet për to, dhe në raporte do të rradhitin të gjitha momentet e rëndësishme nga pranimi i lëndës deri në kontroll.

Gjykatësit do të japin mendimin e tyre për të:

- a ka arsye subjektive dhe objektive për zvarritjen e lëndës;
- nëse kanë ndonjë vërejtje në lidhje me zgjidhjen e lëndës, ata duhet ta deklarojnë këtë me qëllim të zgjidhjes së lëndëve të vjetra të pazgjidhura.

Raportet për veprimet e ndërmarra dhe vizitat do të përgatiten brenda 8 ditëve nga vizita, dhe do të dorëzohen në Gjykatat Themelore, Këshillin Gjyqësor të RMV-së, Gjykatën Supreme të RMV-së dhe Ministrinë e Drejtësisë të RMV-së.

Me qëllim të monitorimit të vazhdueshëm të punës së secilës Gjykatë Themelore në këtë Gjykatë të Apelit, si dhe të ofrimit të ndihmës profesionale, me kërkesë të Gjykatës Themelore ose me iniciativën e kësaj Gjykate, dhe me kërkesë të gjykatësit të Gjykatës Themelore, do të formohen grupe të përshtatshme pune, dhe në këtë mënyrë për arsye të monitorimit të vazhdueshëm të punës së çdo gjykate dhe dhënies të ndihmës profesionale me kërkesë të Gjykatës Themelore ose me iniciativën e Gjykatës së Apelit në Gostivar, janë formuar grupet e mëposhtme të punës:

#### **1. Për Gjykatën Themelore Tetovë përcaktohen gjykatës:**

##### **PËR SEKTORIN PENAL,**

- Shefajet Hajdari dhe Bekim Mehmedi,

##### **PËR SEKTORIN CIVIL,**

- Velko Strashevski dhe Izet Ismaili.

#### **1. Për Gjykatën Themelore Gostivar përcaktohen gjykatës:**

##### **PËR SEKTORIN PENAL**

- Abdulbari Ramadani dhe Gjerasim Gjerasimoski,

##### **PËR SEKTORIN CIVIL,**

- Ali Aliu dhe Rafis Idrizi.

#### **1. Për Gjykatën Themelore Kërçovë përcaktohen gjykatës:**

##### **PËR SEKTORIN PENAL,**

- Shefajet Hajdari dhe Abdulbari Ramadani,

##### **PËR SEKTORIN CIVIL,**

- Rafiz Idrizi dhe Zlatko Angjeloski.

#### **1. Për Gjykatën Themelore Dibër përcaktohen gjykatës:**

##### **PËR SEKTORIN PENAL**

- Bekim Mehmedi dhe Gjerasim Gjerasimoski,

##### **PËR SEKTORIN CIVIL,**

- Afrim Jakupi dhe Liljana Ickaova.

Për të monitoruar situatën në Gjykatat Themelore, gjyqtarët e caktuar për të ofruar ndihmë juridike nëse është e nevojshme do të kërkojnë nga Kryetarët e Gjykatave Themelore informacione të caktuara. Për përcaktimin e gjyqtarëve për të dhënë ndihmë juridike dhe për të monitoruar situatën në Gjykatat Themelore të veçanta të Gjykatës së Apelit Gostivar do të njoftohen Kryetarët e Gjykatave Themelore, Këshilli Gjyqësor i RMV-së dhe Gjykata Supreme e RMV-së.

Stafi administrativ dhe teknik do të kryejnë punën menjëherë dhe me efikasitet në suaza të detyrave të parashikuara me aktet e gjykatës dhe që i janë besuar nga ana a Kryetarit të Gjykatës dhe Administratori i Gjykatës.

Çdo punonjës i stafit administrativo-teknik është i detyruar të mbajë regjistër të punës që do të regjistrojë punën e përditshme të kryer për të vlerësuar që do të shërbejnë gjatë vlerësimit të punës.

Udhëheqësi i administratës dhe nëpunësi gjyqësor i përcaktuar Sedulla Memedi do të kontrollojnë punën e të gjithë punonjësve të tjerë, arrdhjen e tyre në punë, daljen gjatë orarit të punës, përfundimin e orarit të punës dhe disiplinën e tyre gjatë kryerjes së detyrave të punës.

Duke marrë parasysh që në Gjykatën e Apelit Gostivar nuk ka të punësuar pjesëtarë të policisë gjyqësore, sigurimin e ndërtesës së gjyqit, personat dhe lëndët, ashtu siç është paraparë me planin e sigurisë të sjellë nga ana e kryetarit të Gjykatës së Apelit Gostivar, do ta kryejnë pjesëtarët e policisë gjyqësore në Gjykatën Themelore Gostivar, që janë të detyruar të mbajnë evidencë për hyrjen e palëve dhe daljen e tyre nga ndërtesa e gjyqit.

Për realizimin e kësaj programe, përgjegjës është Kryetari, gjykatësit, administratori, nëpunësit gjyqësor dhe të gjithë të punësuarit në Gjykatë.

Programi vjetor së të hyjë në fuqi nga data **01.01.2021**.

Kryetar i Gjykatës së Apelit Gostivar  
Bekim Mehmedi